



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-

**NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI**

Rasti: Përfitim Kontrolli i Tërthortë Xerox Spa / XL World Europe Srl

Në datën 7 Tetor 2011, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e përqendrimit të realizuar ndërmjet palëve (Xerox Spa dhe XL World Europe Srl). Marrëveshja e shitblerjes së aksioneve është nënshkruar më datë 20 shtator 2011 me objekt përfitim të 100% të aksioneve të shoqërisë XLW Srl (e cila zotëron 100% shoqëritë shqiptare Voice Star shpk dhe Eagle Connect Shpk.), nga shoqëria Xerox Spa.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- Për **Xerox Spa**: ushtron veprimtari në shitjen dhe dhënien me qera të paisjeve të zyrës dhe sistemeve të printimit si dhe aksesorëve dhe sendeve të konsumueshme, ofrimin e shërbimeve përkatëse të mirëmbajtjes, si dhe ofrimin e shërbimeve të jashtme të përpunimit të dokumenteve.
- Për **XL World Europe Srl**: ofron shërbime të qendrave të thirrjeve ( call center) nga jashtë dhe për jashtë, shërbime të futjes së të dhënave (data entry), shërbime mbështetëse administrative dhe të teknologjisë së informacionit, kërkime në treg dhe shërbime të drejtpërdrejta, shitje dhe zhvillim të software-ve, shërbime konsulence, që përfshijnë dhënien e shërbimeve nga jashtë ( outsourcing of services) në vendet në zhvillim dhe shërbime konsulence të përgjithshme në lidhje me shërbimet e mësipërme. **Voice Star Shpk dhe Eagle Connect Shpk** : kanë si objekt të veprimtarisë së tyre aktivitetin e telemarketingut dhe vecanërisht duke vepruar si qendër e shërbimeve të kujdesit ndaj klientit në formën e zyrës mbështetëse /informuese ( back office customer care service centers ) për klientët e shoqërisë Mëmë të cilët janë me vendndodhje në Itali.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është përqendrim në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe 12, pika 1 të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax ( nr 0355 4 2234 497 ), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)**